

## Politikat e Privatësisë

### Objekti

Objekti i Politikës së Privatësisë, është informimi i përdoruesve që aksesojnë faqen e web-it të shoqërisë “Credins Invest”, të të dhënave personale mbi mënyrën e mbledhjes, përpunimit, shpërndarjes, ruajtjes dhe masave të sigurisë që janë marrë për të dhënat personale përkatëse që deklarohen në faqen e web-it.

### Përdorimi i të dhënave personale

Në kuadër të përdorimit të faqes zyrtare të shoqërisë “Credins Invest” në disa rubrika si:

- Kontakt
- Mundësi Punësimi
- Sugjerime dhe Ankesa
- Log In, Hyrja në llogari

Përdoruesi do të plotësojë disa nga të dhënat personale, të cilat do të mblidhen nga shoqëria.

Të dhënat jepen vetëm për faqen dhe jo për faqe të tjera të cilat vizitohen nga përdoruesi nëpërmjet lidhjeve të tjera. Pala përgjegjëse për trajtimin e të dhënave personale është shoqëria “Credins Invest”.

Shoqëria garanton dhe siguron përdoruesit e faqes së web-it se vepron në zbatimin me rigorozitet të detyrimeve që rrjedhin nga Ligji Nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (i ndryshuar), si dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

Ky njoftim mbi ruajtjen e privatësisë për të arritur mbrojtjen e të dhënave personale nuk përfshin lidhjet midis kësaj faqeje dhe faqeve të tjera. Ne ju inkurajojmë të lexoni deklaratat e privatësisë në faqet e tjera të internetit që ju vizitoni.

### Përpunimi i të dhënave personale dhe Siguria e Informacionit

Të dhënat personale që japin përdoruesit e faqes së web-it, përdoren vetëm për qëllimin e ofrimit të shërbimit ose për plotësimin e kërkesës dhe i komunikohen palëve të treta, vetëm nëse nevojiten për përmbushjen e detyrimeve që kanë lidhje me deklaruesin, duke respektuar kërkesat e ligjit.

Asnjë informacion që rezulton nga deklarimi nëpërmjet faqes së web-it nuk komunikohet ose shpërndahet përveç rasteve kur informacioni kërkohet nga organet kompetente që e fitojnë këtë të drejtë me ligj të veçantë duke respektuar kërkesat e ligjit, ose kur mbajtësi i kuotës në fond shprehet dakord me shkrim për përhapjen e disa të dhënave të caktuara konfidenciale

Në përmbushje të detyrave të saj, shoqëria kryen përpunimin e të dhënave personale të kategorive të subjekteve të të dhënave personale, nëpërmjet mjeteve të qëndrueshme të komunikimit, duke mundësuar ruajtjen e informacionit, në mënyrë që të shihet dhe të përdoret nga shoqëria, për një periudhë kohore të mjaftueshme për qëllimet e informacionit dhe që mundëson kopjimin e pandryshuar të informacionit të ruajtur. Kjo mund të përfshijë edhe informacione konfidenciale për kategoritë e ndryshme të subjekteve.

Të dhënat personale të subjekteve përpunohen në përputhje të plotë me masat e sigurisë të përcaktuara në dispozitat e Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" (i ndryshuar), në mënyrë elektronike dhe manuale.

Shoqëria mbron të dhënat në ambiente dhe sisteme të sigurta deri në përfundimin e afatit të përcaktuar në Udhëzimin Nr. 20, datë 03.08.2012, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, përveç rasteve kur legjislacioni në fuqi e parashikon ndryshe, më pas të dhënat shkatërrohen.

Duke marrë në konsideratë zhvillimet e teknologjisë shoqëria angazhohet të sigurojë përdorimin e informacionit dhe informacionin e sistemeve të teknologjisë me qëllim ruajtjen e integritetit dhe konfidencialitetit të informacionit nën kontrollin e saj.

### **Konfidencialiteti**

Punonjësit e shoqërisë në momentin e punësimit nënshkruajnë deklaratën "Për ruajtjen e sekretit dhe informacionit konfidencial".

Punonjësit e shoqërisë ruajnë konfidencialitetin e të dhënave të cilat i kanë përfituar gjatë kryerjes së detyrës. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit vazhdon edhe pasi punonjësi ka ndërprerë marrëdhëniet e punës me shoqërinë.

Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit zbatohet edhe për personat që kryejnë detyra në emër të shoqërisë administruese të fondeve, përfshirë subjektet të cilave u është deleguar një funksion i caktuar, si dhe punonjësve të tyre.

Informacioni konfidencial trajtohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Ky informacion u vihet në dispozicion organeve të procedimit penal dhe organeve gjyqësore me kërkesën e tyre, si dhe mund të bëhet publik pas marrjes së pëlqimit të personit/institucionit, që e ka dhënë këtë informacion dhe/ose që preket nga ky informacion.

### **Informim mbi përpunuesit**

Shoqëria Credins Invest në zbatim të legjislacionit në fuqi, mund të transferojë të dhënat personale të deklaruara nga klienti tek "përpunuesit", "nënpërpunuesit" ose "palë të treta" brenda ose jashtë vendit duke respektuar masat e sigurisë dhe do t'i ruajë deri në afatet e parashikuara në legjislacionin në fuqi.

Në kuptim të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale "përpunues" janë partnerë ose mbikëqyrës të Shoqërisë Administruese, të cilët për arsye kontraktore/ligjore mund të përpunojnë të dhëna për llogari të Shoqërisë Administruese, në cilësinë e kontrolluesit si:

- Auditorët e jashtëm të Shoqërisë Administruese.
- Kompania e sigurimit të jetës (vetëm për klientët të cilëve u prodhohet polica e sigurimit të jetës dhe karta e shëndetit).
- Depozitari i Fondit në të cilin klienti është anëtarësuar.
- Kontraktor për shërbime – Sicred Assistance, Agjentët e fondit përkatës.

- Autoritetet Mbikëqyrëse.

Duke qenë se gjatë transferimit të të dhënave personale, kompetenca për të përcaktuar mjetet e përpunimit i delegohet përpunuesit, gjithsesi përgjegjësia e përgjithshme mbetet ende e shoqërisë administruese e cila gjatë lidhjes së marrëdhënies kontraktuale, duhet të sigurohet që në kontratë të parashikohen kushtet e nevojshme teknike dhe organizative për përmbushjen e detyrimeve të kontrolluesit, për të siguruar të drejtat e subjekteve të të dhënave personale.

Çdo përpunues i të dhënave personale ka detyrimin të marrë të gjitha masat e sigurisë, sipas Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, si dhe t’i përpunojë të dhënat vetëm në përputhje me udhëzimet e kontrolluesit dhe të mos i transmetojë ato, përveç kur ka marrë udhëzim nga kontrolluesi.

Përpunimi i të dhënave personale nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, bëhet sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe çdo informacion që merr Autoriteti gjatë ushtrimit të funksioneve të tij trajtohet si konfidencial dhe nuk publikohet nga Autoriteti, anëtarët e bordit, punonjësit e tij ose kontraktorët dhe përdoret vetëm për qëllime të mbikëqyrjes.

## **Kontakt**

Subjektet e të dhënave personale kanë të drejtë të kërkojnë akses në të dhënat e tyre si dhe të kërkojnë që këto të dhëna të korrigjohen apo të përditësohen në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Kërkesat për informacion mund të dërgohen me e-mail në adresën [contact@credinsinvest.net](mailto:contact@credinsinvest.net)

## **Deklarata personale e përdoruesit**

Duke plotësuar të dhënat e kërkuara:

- Përdoruesi deklaron dhe konfirmon se ka plotësuar në mënyrë të saktë, korrekte, të vërtetë dhe të përditësuar gjithë informacionin e kërkuar.
- Përdoruesi deklaron se jep pëlqimin e tij për procedimin e mëtejshëm të informacionit të dhënë për përdorim të brendshëm nga ana e Shoqërisë “Credins Invest”.
- Subjektet e të dhënave personale janë përgjegjës për përditësimin e të dhënave të deklaruara, për të siguruar që informacioni është përditësuar vazhdimisht dhe në mënyrë të plotë.
- Përdoruesi konfirmon se ka lexuar, kuptuar dhe pranuar kushtet e përdorimit të parashikuara në këtë dokument.

Kjo politikë mbi mbrojtjen e të dhënave personale u hartua me qëllim për të qenë të qartë dhe të shkurtër. Nuk jepen detaje të plota të të gjitha aspekteve të mbledhjes dhe përdorimit të të dhënave personale nga ana e shoqërisë administruese. Megjithatë, ne jemi të gatshëm t’ju japim çdo informacion shtesë apo shpjegim të nevojshëm. Çdo kërkesë për këtë duhet të dërgohet në adresën e [contact@credinsinvest.net](mailto:contact@credinsinvest.net)